



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of lokal government Administration

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të nenit 11 të Ligjit për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149, shpall :

KONKURS

Titulli i postit: Zyrtar i lartë për çështje ligjore pronësore në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës

Njësia: Drejtoria për Shërbime Publike, Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut (ZAMV)

Niveli i pagës/gradës :

Orari: 40 orë në javë

Raporton tek: Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, ZAMV

Koeficienti:

Referenca:

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

1. Përpilon propozimet për eksproprijim pasi të jetë përcaktuar interesi publik për ndërtime apo zhvillimin e punimeve tjera;
2. Shqyrton kërkesat për eksproprijim nga palët e interesuara;
3. Përgjegjës për dërgimin e ofertës pronarit të pronës së paluajtshme të eksproprijuar dhe merr informata mbi faktet që mund të jenë tv

rëndësishme për caktimin me marrëveshje të lartësisë së shpërblimit;

4. Pas marrjes së vendimit për eksproprijim, me procesverbal mban caktimin e me marrëveshje të shpërblimit për pasurin e paluajtshme të eksproprijuar;
5. Përgjegjës për dërgimin e vendimit për eksproprijim, gjykatës komunale me qëllim të caktimit të shpërblimit;
6. Ofron këshilla profesionale në çështjet që kanë të bëjnë me eksproprijim;
7. Përgatit procedurat për lidhjen e kontratave mbi dhënien me qira të tokës ndërtimore;
8. Ofron këshilla për tokën bujqësore të eksproprijuar të bujqve, të cilët tokën e kanë burim të ekzistencës, kompensimi i një toke tjetër po ashtu bujqësore në pronësi të Komunës;
9. Siguron menaxhimin e pronës Komunale;
10. Përgatit raporte për Drejtorin;
11. Kryen të gjitha detyrat që i jepen nga Drejtori i Drejtoratit;

Aftësitë dhe shkathtësitë:

- Shkathtësi të dëshmuara në të menduarit strategjik, aftësi të planifikimit, shkathtësi në aplikimin e planeve dhe punës në grup;
- Aftësi për punë në mjedis multi-etnik;
- Aftësi për punë nën presion;
- Aftësi të mira ndër njerëzore dhe mbajtja e kontaktit me personat të cilët marrin vendime;
- Njohja e gjuhëve zyrtare, ndërsa njohja e gjuhës angleze do të merret si përparësi;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme komunikimi;

Kualifikimi dhe përvoja:

- Diplomë Universiteti-fakulteti në drejtësi apo fusha tjera relevante.
- Përvojë pune në fushat relevante, preferohet të ketë përvojë pune menaxheriale;
- Njohuri bazike mbi legjislacionin e pushtetit lokal dhe fushës profesionale;

- Aftësi të mira të punës me kompjuterë (me aplikacionet Microsoft, internet etj.);

Procedura e aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren në Zyret e Ekipit Pergaditor per Mitrovicën e Veriut dhe Qendrën për Shërbime të Qytetarëve në Lagjen e Boshnjakëve ose në adresën elektronike <http://kk.rks.gov.net/mnao/> Numri kontaktues 038-200 35 084; 038/200 35 082 prej orës 08:00 deri 16:00, çdo ditë pune.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërën nga gazetat ditore.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën, certifikata e shtetësisë dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur në listën e ngushtë dhe të ftuar në intervistë doemos duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale si dhe të kenë me vete kartën e identitetit (letërnjoftimin).